



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-75
Prishtinë, më 21 korrik 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 21 KORRIK 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Myfera Shinik dhe Slobodan Petroviq, anëtarë të Kryesisë.

Kryetarët e grupeve parlamentare: Ramë Buja, Lulëzim Zeneli, Xhezair Murati dhe Bojan Stojanoviq, kurse munguan: Lutfi Haziri, Ardian Gjini dhe Ibrahim Makolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Sherif Konjufca dhe Selman Ymeri.

Nga NDI-ja, Rinor Beka dhe Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe tri (3) pika shtesë.

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 korrik 2009.
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 korrik 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 korrik 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare **vendosi** që seanca e ardhshme e Kuvendit të mbahet **më 24 korrik 2009**, me këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurim Publik,
3. Shqyrtimi i Propozimit të Kryesisë së Kuvendit për formimin e tri komisioneve parlamentare.

Në lidhje me pikën e propozuar për Rregulloren e Punës së Kuvendit, Kryesia pas diskutimeve të Xhavit Halitit, Nexhat Dacit, Naim Malokut, Ramë Bujës dhe Sabri Hamitit, vendosi që kjo pikë të mos shqyrtohet në seancën plenare të 24 korrikut 2009, por u vendos që Kuvendit t'i propozohet për shqyrtim dhe miratim formimi i tri komisioneve të reja parlamentare.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, datë 15 korrik 2009,

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, vendosi që ajo të radhitet për seancë plenare pas pushimeve verore 2009.

3.2 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës

Kryetari informoi Kryesinë se Qeveria e Kosovës, ndërkohë ka kërkuar tërheqjen e këtij Propozim-vendimi.

Kryesia, miratoi kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e këtij Propozim-vendimi.

3.3 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e lartshënuar të Qeverisë së Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Propozim-vendimi i Qeverisë t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Komisioni duhet që Kuvendit t'i paraqesë Raportin me rekomandime.

3.4 Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuajin e parë të vitit 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuajin e parë të vitit 2009, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

3.5 Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin e sistematizimit në Sektorin për Marrëdhënie me Publikun dhe Media

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e lartshënuar, vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e ardhshme të Kryesisë, por paraprakisht duhet që Kryesisë t'i prezantohen materialet me shkrim për këtë çështje.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës së disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës nga komuna e Prishtinës për t'ua siguruar një zyrë për komunikim me qytetarë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, vlerësoi se grupi i deputetëve në fjalë duhet shikuar mundësitë me komunën e Prishtinës për sigurimin e një zyreje.

3.7 Ratifikimi i anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Bankës Botërore

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, vendosi që kjo pikë të shqyrtohet si pikë e përbashkët me pikën numër 9 të seancës plenare të datës 23 korrik 2009.

3.8 Ratifikimi i Marrëveshjes për nxitje të investimeve ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Marrëveshjen për nxitje të investimeve ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit t'i paraqesë Raportin me rekomandime.

3.9 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës dhe Kuvendit t'i paraqesë Raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**